

KONCEPTI POPULLOR PËR TË BUKURËN NË LIRIKËN E DASHURISË

Merita GJOKUTAJ-SHEHU
Departamenti i letërsisë
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Dashuria është fenomen njerëzor që lidhet me jetën, me familjen, me vazhdimësinë e llojit. Në mënyrë të veçantë, në këngët e dashurisë, më shumë se kudo del koncepti popullor për të bukurën si ideal, si përsosmëri, si harmoni midis anës së brendshme dhe të jashtme, bukurisë fizike dhe shpirtërore, për të bukurën, të mirën dhe të dobishmen.

Këngët e dashurisë kanë rëndësi të madhe, mbasi në to derdhet thesari i madh i ndjenjave të pastra të shqiptarit, në to jepet ideali i popullit për femrën në mënyrë të veçantë dhe për familjen në mënyrë të përgjithshme.

Të ndërton portretin fizik të vashës, poeti popullor krijon përfytyrimin ideal të saj, duke shfrytëzuar me mjeshtëri mundësitë që krijon figuracioni i pasur popullor. Retorika popullore e dashurisë është shprehje e dëshirës së njeriut për të ngritur individualen dhe të papërsëritshmen e përjetimeve të veta në nivelin e një tipi. Prandaj, edhe portreti i vashës është një imazh i bukurisë së idealizuar që përbëhet nga tërësia e disa vetive fizike të kodifikuara poetikisht në përputhje me një tip të caktuar botëkuptimi.

Duke parë këngët e dashurisë vëmë re se populli në to paraqet faktin thuajse në mënyrë objektive, pa dënuar askënd e pa mbajtur anën e askujt, haptazi. Populli në poezinë e tij nuk është kurrë as moralist, as fanatik. Ai qëndron mbi ngjarjet, mbi dukuritë, por nuk është vështirë të kuptosh se ai merr në mbrojtje

ndjenjën e pastër të dashurisë edhe kur kjo është shkatërruese për individin a për mjedisin, mbasi për të zëri i dashurisë është zëri i jetës.

Nga pikëpamja artistike këngët e dashurisë janë nga më të realizuarat. Edhe mjetet shprehëse janë lirike. Si elemente krahasimi gjejmë shpesh lulen, dritën e hënës, bilbilin, thëllëzën dhe jo luanin, trimin, dragoin. Krahasimet, metaforat dhe epitetet që përdoren si për vajzën dhe për djalin janë nga më të bukurat, të marra nga bota e luleve dhe e blegtorisë, por nuk mungojnë edhe metafora të tilla që, në anën e jashtme duken të ashpra, por në brendi të tyre fshehin një zjarr të madh ndjenje dhe shpirti lozonjar. Gjithë lënda ilustruese është vjelë në ambient fshatar. Ato dallojnë nga brendia se na ringjallin një mjedis përgjithësisht bukolik, të thjeshtë, pa shumë koklavitje. Spontaniteti dhe sinqeriteti në këto këngë janë të dukshme. Kanë një realizëm të thellë. Ajo është një dashuri tokësore, jo hyjnore. Kemi një shfrytëzim mjeshtëror të detajeve, thjeshtësi të ndërtimit, s'kanë asnjë lloj komplikimi a megjulle dhe nga mënyra si ndërtohen mbahen mend me lehtësi.

Dashuria është fenomen njerëzor që lidhet me jetën, me familjen, me vazhdimësinë e llojit. Në konceptin popullor dashuria është një ndjenjë intime dhe shoqërore, prandaj edhe këngët rreth saj në popull janë të shumta e të bukura.

Në mënyrë të veçantë, në këngët e dashurisë, më shumë se kudo del koncepti popullor për të bukurën si ideal, si përsosmëri, si harmoni midis anës së brendshme dhe të jashtme, bukurisë fizike dhe shpirtërore, për të bukurën, të mirën dhe të dobishmen.

Në krijimtarinë tonë folklorike kjo ndjenjë është materializuar artistikisht në një numër mjaft të madh këngësh, ku poeti popullor ka pasqyruar jo vetëm botën e tij të pasur e të gjerë shpirtërore, por në mjaft prej tyre ka reflektuar edhe marrëdhëniet shoqërore e normat morale nga të cilat është varur shpeshherë përmbushja e dashurisë.

Këngët e dashurisë kanë rëndësi të madhe, mbasi në to derdhet thesari i madh i ndjenjave të pastra të shqiptarit, në to jepet ideali i popullit për femrën në mënyrë të veçantë dhe për familjen në mënyrë të përgjithshme. Në to zbulohet vizioni i përparuar për jetën dhe marrëdhëniet midis sekseve që populli ruante thellë në zemër, edhe pse kanunet dhe zakonet, përgjithësisht, ishin kundër dashurisë.¹

Duke e shikuar problemin në tërësi, duhet të themi se në jetë kishte një kontrast të qartë midis zakoneve që nuk e pranonin dashurinë dhe këngëve të shumta që i këndoheshin asaj. Në jetën e tij

¹ Zheji, Gj. *Këngët e dashurisë*. Folklori shqiptar. Tiranë, 1998. F. 82.

populli, në shumicën e rasteve, nuk e ka pranuar dashurinë, kurse në artin e tij nuk e ka dënuar kurrë.²

Kjo nuk do të thotë që këngëve lirike u mungon realizmi. Madje ka debate: a janë, a s'janë realiste këngët lirike? Problemi s'duhet shtruar kështu. Ndjenjat e shprehura në lirikë janë thellësisht tokësore, jo të imagjinuara, pra reale. Edhe personazhet janë tokësorë: baresha, bujkësja, vajza me shami mënjanë etj. po ashtu edhe mjediset janë tipike, tokësore: krojet, burimet, stanet, arat etj.

Kur flasim për realizëm dhe jo realizëm duhet të mbajmë parasysh faktin se kemi të bëjmë me art dhe jo me fotografim apo kopjim. Realizëm s'do të thotë kopjim i realitetit, por tjetërsim i tij. E vërteta artistike s'është e barabartë me të vërtetën jetësore. E vërteta artistike pranohet e veshur, e rijetuar, e tjetërsuar.

Kur zë të shkruash për femrën shqiptare si figurë individuale dhe shoqërore, padashur të kujtohen fjalët e nënave dhe gjysheve tona: "kur lind vajza edhe trarët e shtëpisë qajnë!" Krejt e kundërta ndodh duke shfletuar korpusin poetik të lirikës sonë erotike, në veçanti lirikën e dasmës tradicionale gjirokastrite, ku bie në sy menjëherë mënyra e veçantë me të cilën këngëtari popullor ndërton e poetizon portretin fizik të vashës.

Portreti i saj merr forma të larmishme, të cilat zbulojnë evoluimin e estetikës popullore për të bukurën si dhe nuancat e saj lokale. *Sizezë vetulla llaja/ Kur kërceje na kazaja/ posi bej na kasabaja./ Të kanë zili dinjaja/ Moj leshdredhura mënjanë/ Moj leshdredhur e Misirit/ Mos i bën zarar fiqirit/ Se je si bij e Vezirit.*

Të ndërton portretin fizik të vashës, poeti popullor krijon përfytyrimin ideal të saj, duke shfrytëzuar me mjeshtëri mundësitë që krijon figuracioni i pasur popullor. Retorika popullore e dashurisë është shprehje e dëshirës së njeriut për të ngritur individualen dhe të papërsëritshmen e përjetimeve të veta në nivelin e një tipi. Prandaj, edhe portreti i vashës është një imazh i bukurisë së idealizuar që përbëhet nga tërësia e disa vetive fizike të kodifikuara poetikisht në përputhje me një tip të caktuar botëkuptimi. *Moj e bukura si ylli / shtatë drita të bën syri/ Të feksin si xhevahiri...; As aman o syri i zi,/ ç'më ke bërë sevdalli./ As aman o syri i shkruar/ ç'na ke djegur, përvëlur! Sytë e vashës flasin e kuvendojnë, qe-*

² Kadare, I. Autobiografi e popullit në vargje. Tiranë, 1971. F. 15.

shin e lozin, lëshojnë xixa e shkëndija, godasin e lëndojnë e përsëri shërojnë.

Parimi i zbukurimit e bën figurën e vajzës një figurë ideale, flokët e sytë e saj i duken të dashurit më të bukurit në botë... (pa merr sytë e mi). Këtu nuk kemi mundësi të realizimit, por heroji shpreh atë që ndjen.

Duke lënë mënjanë prirjen jo rrallë hiperbolizuese të të menduarit poetik, me gjuhën e përmbajtur të hulumtimeve mund të themi se edhe në lirikën e dasmës tradicionale gjirokastrite nusja është sa reale aq edhe e përfytyruar, sa e vërtetë edhe e dëshiruar. Me gjuhën e poetit mund të thuash se nusja është sa tokësore aq edhe qiellore.

Duke dashur të gjenim diçka nga qielli, në kuptimin fizik të fjalës “qiell” te nusja, kjo mund të perceptohet në dy elemente: e para: përqasja me trupa qiellore dhe e dyta: dëshira për të dhënë një portret rrezatues që lëshon dritë.

Më së shumti në lirikën e dasmës gjirokastrite – dhe jo vetëm të saj- nusen do ta gjesh të pranëvënë me hënë, herë në trajtë paralelizmi a krahasimi të shprehur, e herë të tipit metaforik: “*Ulu mal të dalë hëna/ Të na stoliset kadena...*”.

Nusja e stolitur do të ngjajë si hënë e porsadalë: “*Tani jam i ballëhënës*”- thotë dhëndri në dialogun e imagjinuar të këngës. Emërtimi “*ballëhënë*”, i karakterit metaforik, i atribuohet nuses dhe mbart: bukuri, rrezatim, mister nate e mbase edhe inteligjencë: ballë i gjerë, i hapur. Të gjitha këto varen jo vetëm nga krijuesi, por edhe nga perceptuesi.

Krahas hënës përqaset me “yllin” “*Hape vallen mos e mbyll/ aman yll, o more yll...*”, përqaset me diellin “*Sos je diell, sos je hënë...*” etj. Të bën përshtypje pëlqimi i poetit për të futur sa më tepër rrezatim në portretin e nuses: “*Të ka stolitur jot’emë/ që në mes e lart ergjëndë*”.

Duke parë këngët e dashurisë vëmë re se populli në to paraqet faktin thuajse në mënyrë objektive, pa dënuar askënd e pa mbajtur anën e askujt, haptazi. Populli në poezinë e tij nuk është kurrë as moralist, as fanatik. Ai qëndron mbi ngjarjet, mbi dukuritë, por nuk është vështirë të kuptosh se ai merr në mbrojtje ndjenjën e pastër të dashurisë edhe kur kjo është shkatërruese për individin a për mjedisin, mbasi për të zëri i dashurisë është zëri i jetës. *Bejë drru në përcëllimë/ Moj Maro, moj Marinë/ Lësho drut’ e lidh shaminë/ Gjidhi mirë djemurinë/*

*Mos u vështro bukurinë/ Po vështroju trimërinë/ Kush futet në vetëtim/
Kush i thot' dufekut prim.*

Nga pikëpamja estetike zotëron e bukura, *Gusha e mikes me rreth/ si trëndafili me vesë/ Kush ta puthë, le të vdesë...* Këto krijime kanë vlera të veçanta artistike, sidomos të tërheqin vëmendjen mjeshtria si përdoret gjuha poetike për të zbuluar përmbajtjen, larmia e pasuria e mjeteve shprehëse, përdorimi i tyre etj.

Nga pikëpamja artistike këngët e dashurisë janë nga më të realizuarat. Edhe mjetet shprehëse janë lirike. Si elemente krahasimi gjejmë shpesh lulen, dritën e hënës, bilbilin, thëllëzën dhe jo luanin, trimin, dragoin. Krahasimet, metaforat dhe epitetet që përdoren si për vajzën dhe për djalin janë nga më të bukurat, të marra nga bota e luleve dhe e blegtorisë, por nuk mungojnë edhe metafora të tilla që, në anën e jashtme duken të ashpra, por në brendi të tyre fshehin një zjarr të madh ndjenje dhe shpirti lozonjar.

Të tërheqin vëmendjen: paralelizmat e goditura, zakonisht me objekte të natyrës. Sundojnë ngjyra të ndritura, të pastra, të gjalla. Tingujt janë ato të natyrës: kënga e zogut, e vijës së ujit, fëshfërima e gje-theve, këmbora, cula, tingulli i varësës së vajzës, i byzylykut etj, etj.

Zakonisht i dashuruari nuk e lëshon veten, di të ruajë një pamje të jashtme të shtirë si të pavuajtur, sikur nuk çan kokën, duke mbuluar me një shaka tërë trazimin që i zien në zemër. *Mexhite bardha bër-dhërë/ Lum nëna që të ka bënë/ del në penxhere si zonjë/ surrati ana-polonë/ del potis vasilikonë/ Del në penxhere na udha/ me di qelqe si kushulla.*³

Shpesh këngët e dashurisë kanë formën e dialogëve ku shkëmbejnë batuta, herë edhe me shaka, edhe me të hedhur, edhe me nënkuptime, djali dhe vajza. Herë tjetër ajo merr trajtat e një rrëfimi në vetën e parë, si një monolog në miniaturë që shtron dilemën e një zemre. Shumë nga këto këngë janë të tilla që shoqërohen me valle. *Thëllëza bigë më bigë/ Ja merr e ja kthen me griqë/ Përpara shoqeve gjith'/ Në qaf' varur hajmalitë/ Kush t'i bleu hajmalitë/ Ai që më hapi sitë.*⁴

Të shoqëruara me melodi nga më të ndryshmet dhe duke pasur parasysh faktin që në këngët e dashurisë njohim kombinime nga më të bukurat, këngët e dashurisë paraqiten në vargje e forma të ndryshme

³ Nurihan Bala, 80 vjeç, analfabete. Prongji. Gjirokaster

⁴ Po ajo.

strofike, një pasuri e madhe metrike kjo, që dëshmon për pasurinë e melosit popullor.

Intonacionet, tonet e lirikës nuk janë maxhore, por të buta, të qeta; jo forcë, imponim, por finesë, hir, delikatesë. Midis personazheve lirikë krijohen marrëdhënie delikate, plot finesë e hijeshi, me një elegancë kristalore.

Dielli buzës e malit/ Shelege bejk e çobanit/ Po ti s'jeshe për çobanë/ Po për djalë kapedanë/ ti maje qelqe filxhanë/ Qelqe filxhanë me verë/ Mos i bëje def qederë/ Manushaqeja në ferrë/ Qasu djal' e merru erë/ Se këto s'vijne na herë/ Po në vit, në vit njëherë.⁵

Këto këngë mbajnë vulën kolektive, mbajnë mijëra vula të disa brezave, që i kanë krijuar e pranuar, i kanë përpunuar dhe i kanë mbajtur gjallë, pavarësisht nga prania e elementit individual. Kane vlera edhe ato poezi që janë ndërtuar si fate individuale në ligjërimin poetik të vetës së parë njëjës.

Ato afrohen midis tyre nga tema në kuptimin e gjerë të fjalës, sepse trajtojnë aspekte të ndryshme që lidhen me jetën zakonore e morale të popullit, kryesisht me familjen. Shumë prej tyre qeshin e përqeshin pa kursim e pa rezerva aspekte të jetës familjare, elemente të jetës zakonore që vetë populli i zbaton. Populli përqesh ato praktika që vetë i zbaton në jetë. Kjo duket si një kundërshti midis artit dhe realitetit. Por shqyrtimi konkret i lëndës poetike në imtësi tregon mirëfilli se këto poezi janë pasqyrim i realitetit, me realizëm dhe objektivitet.

Vetë zbatimi i normave zakonore ka qenë një zhvillim me kundërshti e konflikte të mprehta që kanë pasur edhe anën e vet komike, sidomos procesi i braktisjes dhe i shfuqizimit të disa normave zakonore, trajtimi kritik i tyre në jetë duke bërë lëshime, modifikime ose zëvendësime me zakone të reja.

Tërheq vëmendjen riprodhimi me vërtetësi i mjediseve reale. Idilet e dashurisë zakonisht zhvillohen në mjedise pune, midis pastërtisë dhe virgjërisë së natyrës: në lëmë, te burimi, në krua, në stan, te shkëmbi ku punon bleta, te lisi në brinjë etj. *Moj e vogëla në lëmë, moj e vogëlo/ Seç të feksën ato llërë, moj e vogël –o/ As mi jep t'i bëj gjilpër/*

⁵ Po ajo.

Të të qep sadenë⁶ prëmë/ U saden qepur e kam/ Rroj' e rrotull me gajtan/ Erdhë shoqet e ma panë/ E griç me shëndet më thanë.⁷

U ngreçë pa dalë illi/ U fola shoqeve dili/ Dili a u daltë siri/ Të vemi për dru na bliri/ Atje tek këndon bilbili/ Këndona birbil këndona/ Në na zëntë gjumi xgjona/ Në raftë vesë mulona.⁸

Në Pazar dolla një ditë/ në avlli më vanë sitë/ në penxhere qe një dritë/ truli-truli ti stolit/ Baluket të zunë site/ Qish i mban a gjeç belanë/ Si diku trimat fustanë/ Si fishekët në gjerdanë.

Aman xhiko karafille/ ku shkoje te porta time/ keshe vathët me zimbile/ Nami mua moj bandille/ U t'i jap po vall i do/ Shelege vogël mono/ dil te porta të të shoh/ Surratin mos ma dëfto/ Po mesin e hollë mono.⁹

Gjithë lënda ilustruese është vjelë në ambient fshatar. Ato dallojnë nga brendia se na ringjallin një mjedis përgjithësisht bukolik, të thjeshtë, pa shumë koklavitje. Spontaniteti dhe sinqeriteti në këto këngë janë të dukshme. Kane një realizëm të thellë. Ajo është një dashuri tokësore, jo hyjnore. Kemi një shfrytëzim mjeshtëror të detajeve, thjeshtësi të ndërtimit, s'kanë asnjë lloj komplikimi a mjegulle dhe nga mënyra si ndërtohen mbahen mend me lehtësi.

LITERATURA

Lirika popullore 2. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë 1988.

Gjergj Zheji. Këngët e dashurisë. Folklori shqiptar. Tiranë 1998.

Ismail Kadare. Autobiografi e popullit në vargje. Tiranë 1971.

Eqrem Çabej. Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes. Tiranë 1994.

Tasim Gjokutaj. Lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite. Tiranë, 1996.

Zymer Ujkan Neziri. Poetika e krahasimit. Prishtinë, 2004.

⁶ Fustan

⁷ Nurihan Bala, 80 vjeç, analfabete. Prongji. Gjirokaster

⁸ Po ajo.

⁹ Po ajo.

Merita GJOKUTAJ-SHEHU

POPULAR CONCEPT ON THE BEAUTIFUL IN LOVE LIRICS

Resume

Love is a human phenomenon connected with life, family, and continuation of species. In particular way, in love songs, more than anywhere comes out popular concept on the beauty as an ideal, as perfection, as a harmony between the inner and the extern, physical and spiritual beauty, on the beauty, the goodness and the wholesome.

Love songs have great importance since in them is poured the great treasure of clean feelings of Albanians, in them is given peoples ideal about the female in a special way and about the family generally.

To build physical portrait of a girl, popular poet creates her ideal image, using skillfully possibilities made by rich popular figuration. Popular rhetoric of love is expression of humans desire to build the individual and unrepeatable of own experiences in the level of a single type. Thus, the portrait of a girl is an image of idealized beauty consisting of totality of physical features codified poetically in harmony with a certain type of the worldview.

By observing love songs we notice that people in them present the facts almost objectively, without condemning anyone and without taking sides, openly. People in their poesy is never neither moralist, neither fanatic. He stands beyond the events, beyond the phenomena, but it is not difficult to understand that he takes under protection a clear feeling of love even when it is disastrous for the individual or for environment, since for the people the voice of love is the voice of life.

From artistic point love songs are among most figured. Expressive modes are also lyrical. As comparative elements we can often find flower, moon light, nightingale, pintail and not the lion, courageous, dragon. Comparisons, metaphors and epithets used both for the girl and the boy are the most beautiful, taken from the world of flower

and farming, but there are no absent such metaphors that, from the outside seem hard, but inside them are hidden a great flame of feelings and playful spirit. Entire illustrative matter is harvested in a peasant atmosphere. They differ from inside since they reanimate a generally bucolic environment, simple one, without plenty of complication. The spontaneity and sincerity in these songs are obvious. They have a deep realism. It is an earthy love, not heavenly. We have a master usage of details, simplicity of structure, they have no kind of complication or haziness and from the way they are structured they are easily remembered.

